



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 24 janar 2013
Nr. ref.: MP354/13

VENDIM PËR VAZHDIMIN E MASËS SË PËRKOHSHME

në

Rastin nr. KO97/12

Parashtruesi

Institucioni i Avokatit të Popullit

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së neneve 90, 95 (1.6), 110, 111 dhe 116 të
Ligjit për Banka, Institucione Mikrofinanciare dhe Institucione
Financiare Jobankare, Nr. 04/L-093, të 12 prillit 2012**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, Gjyqtar
Altay Suroy, Gjyqtar
Almiro Rodrigues, Gjyqtar
Snezhana Botusharova, Gjyqtare
Kadri Kryeziu, Gjyqtar dhe
Arta Rama-Hajrizi, Gjyqtare

Hyrje

1. Më 24 dhjetor 2012, Gjykata Kushtetuese vendosi masë të përkohshme në lidhje me Kërkesën e lartpërmendur. Në vendimin e saj, Gjykata Kushtetuese, mes tjerash, vendosi:

“...

- I. TË LEJOJË masën e përkohshme
- II. TË LEJOJË masën e përkohshme në kohëzgjatje deri më 31 janar 2013 prej ditës së miratimit të këtij Vendimi
- III. TË PEZULLOHET MENJËHERË zbatimi i neneve 90, 95 (1.6), 110, 111 dhe 116 të Ligjit për Banka, Institucione Mikrofinanciare dhe Institucione Financiare Jobankare, Nr. 04/L-093, të 12 prillit 2012, në kohëzgjatje të njëjtë;

...”

2. Sa i përket vazhdimin e Masës së Përkohshme si më lart, Gjykata rithekson që zbatimi i Ligjit nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikro-Financiare dhe Institucionet Mikro-Financiare dhe Institucionet Financiare Jo-Bankare, më saktësisht i neneve të kontestuara 90, 95 (1.6), 110, 111 dhe 116 do të mund të shkaktonte dëme të pakthyeshme në funksionimin e OJQ-ve, si dhe shoqërisë civile dhe interesit publik në Republikën e Kosovës.
3. Në këtë drejtim, duke pasur parasysh që afati kohor i Masës së Përkohshme vendosur nga Gjykata më 24 dhjetor 2012 do të skadojë më 31 janar 2013, si dhe që Gjykata më 24 janar 2013 mori vendim të mbajë dëgjim publik, pa paragjykuar rezultatin përfundimtar të Kërkesës, afati kohor i Masës së Përkohshme vazhdohet për tre (3) muaj.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, në bazë të nenit 116(2) të Kushtetutës, nenit 27 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, si dhe Rregullit 55 të Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese, pasi shqyrtoi çështjen më 24 janar 2013, njëzëri

VENDOSI

- I. TË VAZHDOJË afatin kohor të Masës së Përkohshme të vendosur nga Gjykata në vendimin e saj fillestar të datës 24 dhjetor 2012, për një periudhë të metutjeshme prej tre (3) muaj deri më 30 prill 2013;
- II. TË MBETET e përkushtuar për çështjen;
- III. Ky vendim do t'u komunikohet Palëve; dhe
- IV. Ky Vendim do të shpallet në pajtim me nenin 20(4) të Ligjit, si dhe hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Enver Hasani

